

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Nëse kërkon në Google me termin “skandal politik në Shqipëri”, të dalin disa gjetje. Ndër to spikatin veçanërisht pesë prej tyre, të lidhura me të njëjtin emër: Sali Berisha. Disa prej tyre datojnë hershëm: 1996, 1997, 1998, ndërsa dy të tjerat disi më pas: Gërdeci në vitin 2008 dhe 21 janar në vitin 2011. Sa i takon përmbajtjes, ato kanë nga të gjitha thagmat që një politikan mund të mbjellë: masakër elektorale, rënie e shtetit, heqje e të drejtës për të jetuar, tentativë për marrjen e pushtetit me dhunë, masakër ndaj popullsisë. Të pesta këto janë saga të përgjakshme, të shënjuara me qindra jetë njerëzish të pafajshëm. Edhe pse deri në vitin 2008 mediet sociale dhe portalet nuk ishin ende në lulëzim të plotë si sot, kjo nuk i ka penguar këto ngjarje të gdhenden në listën e zezë të memories ndërkombëtare, sepse ato nuk kishin nevojë për instrumente amplifikimi, por ishin mjaftueshëm të forta e të vërteta. Literatura e përkufizon “skandalin politik” si “një ngjarje ose veprim i konsideruar moralisht ose legalisht i gabuar, që shkakton një zemërim popullor”. Vini re: “...që shkakton një zemërim popullor”! Opozita po e përdor kauzën e një skandali pikërisht për fuqinë që ai ka, që të shkaktojë zemërim popullor, të cilin opozita vetë nuk ka mundur ta provokojë. Po si t’ia bëjë një opozitë si kjo jona, kur as nuk mund të krijojë frymë dhe as nuk provokon dot një zemërim popullor? Kësaj opozite i mbetet vetëm një shpresë, një kombinim i qepur trashë i ca news me ca fake news, plus fuqinë e medias.

Është e njohur që në shekullin XXI marrëdhënia midis skandalit dhe fuqisë së medias. Është pikërisht aftësia për të bërë të dukshëm njerëz të caktuar, në një moment të caktuar, ajo që i jep fuqinë e veçantë medias. Dukshmëria e beftë e emrit McGonigal këto ditë, është një shembull i qartë i kësaj fuqie. Kjo është fuqia e medias në shekullin XXI, kur partitë përpiqen të dominojnë fushatat, duke përdorur etikën personale të politikanëve për të joshur elektoratin gri. Por opozita jonë e ka hallin më të madh se kaq, sepse, përveç joshjes së elektoratit gri, i duhet të joshë edhe elektoratin e nuancave të blusë, dhe kjo ia bën shumë më të vështirë punën. Në ditët që po rrjedhin me shpejtësi drejt 14 majit, nuk ka kohë për mënyra kristiane për opozitën tonë të copëtuar. E vetmja mënyrë për ta shpresuar këtë është përmes kapjes pas ndonjë skandali, i cili, duke e njoftosur kundërshtarin, garanton njëkohësisht bërjen e tij objekt të vizibilitetit të lartë mediatik, natyrisht, nën një dritë të keqe. Opozita ka kohë që është në kërkim të një skandali politik, të atij që shkakton zemërim popullor, por nuk ka mundur ta gjejë dot. Skandale? Po, ka. Në një qeverisje të gjatë, përveç shumë e shumë punëve të dukshme, ka edhe skandale të padukshme, është lupa e shoqërisë dhe e drejtësisë, që i ka nxjerrë e do të vijojë t’i nxjerrë në sipërfaqe për t’i ndëshkuar, por skandale politike jo. Ndaj po kërkon ndihmë me fake news, për t’i kthyer në fake skandale, të tipit “babale”, sepse nuk ka kohë; 14 maji po troket gjithnjë e më fort. “McGonigal”, që për kohë ka qenë ky “Gon”, si saga “babale”, është një histori si ato që shoqërojnë rëndom vende si yni.

Ne jemi një vend i etur për investime të huaja dhe diplomacia ekonomike është një armë e fuqishme për këtë, nëse përdoret mirë. Në tipologjinë e diplomacisë ekonomike, ku ndërmjetës të talentuar lidhin investitorët me vendet e interesit, njihen edhe rastet e përpjekjeve të pasinqerta, pse jo edhe të trafikantëve të interesit. E rëndësishme është që ato të mos materializohen në dëm të vendit, siç nuk ka asnjë të tillë në ndërmjetësimet e tipit personi “A” me personin “B”. McGonigal, ky emër që u bë famoz ku dhe kur nuk ia merrte mendja as atij vetë se do ta meritonte, ka llogari në vendin e vet, dhe në vendin e vet drejtësia as blihet dhe as shitet. Në atë vend, drejtësia nuk kursen liderin e vet e

jo me atë të një vendi të Ballkanit të largët. Ndaj duket groteske një ushtri e zellshme në radhë, kush e kush t'i japi një dorë ndihme drejtësisë amerikane me hipoteza nr.1 e hipoteza nr.2. Me hipoteza ndërtohet "stuhia politike në gotën e opozitës shqiptare", po nuk bëhet drejtësia amerikane, kjo e fundit stuhinë e ngre në oqean. Unë nuk e vë dot dorën në zjarr se sa të sinqerta kanë qenë vizitat në Shqipëri të "A", "B" apo "MC", se nga fotot nga ajri apo nga toka, me lloj -lloj personazhesh, kjo nuk lexohet dot. Por që ata nuk mundën të bëjnë dëm në këtë vend, për këtë jam i bindur, përderisa askush nuk ka mundur të gjejë të kundërtën, me të gjitha përpjekjet. Nëse do të kishin mundur ndonjëherë të sillnin ndonjë mik të mirë për këtë vend në këtë tranzicion të gjatë, do të isha gëzuar. Sa i takon çështjes nëse personi "A" apo personi "B" kanë ndihmuar në demaskimin publik të një lobimi politik me para ruse, besoj se, nëse është e vërtetë, do të dalë në dritë, dhe nëse është e paligjshme, do të ndëshkohet, por kjo i takon drejtësisë së një vendi tjetër. Sa për shqiptarët, besoj se tjetër gjë ka rëndësi. Shqiptarëve u duhet sqaruar nëse ishte i vërtetë lobimi i Partisë Demokratike me para të padeklaruara, siç shkruajnë shtypi amerikan dhe BIRN-i dhe, më tej akoma, a ishin ato para rubla ruse? Kjo për shqiptarët do të thotë pastrim parash, korrupsion dhe interesa okultë antiperëndimorë. Kjo duhet të ishte çështja për diskutim këtu. Ama, sido që të jetë, e gjithë kjo histori nuk prodhoi dot një skandal politik, me gjithë suportin e sofistikuar mediatik, e ndaj nuk prodhoi dot as zemërimin, që i duhej foltores për të ndezur revolucionin popullor, sepse revolucionin secili prej jush duhet ta bëjë më parë brenda vetes, të nderuar kolegë opozitarë. Në fund, kam edhe një këshillë për ju: mos u nervozoni nëpër studiot televizive, se nuk jua kanë fajin gazetarët. Ata bënë më të mirën që mundën, duke i besuar singërisht fake news-it tuaj, por dihet që petullat nuk bëhen dot me ujë. Faleminderit!